



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	29.12.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 469/2
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Pëlqim

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8 , 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren lëshon:

P Ë L Q I M

Investitorit Shaip Kubati nga Prizreni, rruga „Mbreti Zog“ nr. 39 ipet pajtimi për sanimin e murit të dëmtuar të shtëpisë dhe ndërimin e kulmit, në ngastrën kadastrale 021680-0. Gjatë renovimit nuk lejohet asnjë ndryshim në gabaritin e ndërtesë, në volum dhe në dukje.

A r s y e t i m

Kërkesa e parashtruar nga investitori për sanim të murit të dëmtuar të shtëpisë nga dispozicioni i këtij rekomandimi gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit, respektivisht në zonën VI (Zona e shfrytëzimit të përzier dhe banimit) sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit. Në jug të kësaj shtëpie gjendej Shtëpia e Familjes Myftiu (monument në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të përkohshme) i cili u rrënuar pa lejen e insitucioneve kompetente. Gjatë rrënimit të shtëpisë së Familjes Myftiu, është dëmtuar edhe muri jugor i shtëpisë fqinje, respektivisht shtëpisë së Shaip Kubatit.

Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, Komisioni i QRTK-së (Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore) ka shqyrtuar lëndën në fjalë. Pas shqyrtimit të Komisionit dhe vlerësimi të gjëndjes në terren është vlerësuar se palës mund t'i ipet pëlqimi për ndërmarjen e hapave konsoliduese për sanim të murit të dëmtuar.